



VENDIM MBI PRANUESHMËRI

Data e miratimit: 13 qershor 2017

Nr. i lëndës: 2011-27

F. dhe të Tjerë

kundër

EULEX-it

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut i mbledhur me 13 qershor 2017, ku të pranishëm ishin anëtarët e paraqitur në vijim:

Znj. Magda MIERZEWSKA, kryesuese
Z. Guénaël METTRAUX, anëtar
Znj. Anna BEDNAREK, anëtare zëvendësuese

Ndihmuar nga
Z. John J. RYAN, zyrtar i lartë ligjor
Znj. Noora AARNIO, zyrtare ligjore

Pas shqyrtimit të ankesës së lartpërmendur, e cila është dorëzuar në pajtim me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut dhe Rregullores së Punës së Panelit, e ndryshuar për herë të fundit me 15 janar 2013,

Znj. Elka Ermenkova është tërhequr nga kjo lëndë, për shkak të paraqitjes së konfliktit të interesit dhe ajo nuk ka marrë pjesë në shqyrtimin e lëndës, në përputhje me rregullën 12(1)(1) të rregullores së punës së Panelit. Ajo ishte zëvendësuar nga znj. Anna Bednarek.

Pas shqyrtimit, vendosi si në vijim:

I. PROCEDURA PARA PANELIT

1. Ankesa në emër të bashkëshortes dhe dy anëtarëve të familjes së të ndjerit X.F. ishte parashtruar në Panel me datën 14 nëntor 2011.

2. Paneli ka miratuar kërkesën e parashtruesit të ankesës që emrat e tyre mos të zbulohen. Ata do të përmenden si F. dhe të Tjerë.
3. Me 15 dhe përsëri me 30 nëntor 2011, Paneli ka kërkuar informata shitesë nga përfaqësuesi ligjor i ankuesit. Informacioni përkatës ishte dorëzuar me 15 mars 2012.
4. Paneli i ka komunikuar ankesën shefit të Misionit (ShM-së) me datën 16 tetor 2012 dhe ka kërkuar që EULEX-i Kosovë të ofroj vërejtje me shkrim mbi pranueshmërinë dhe bazueshmërinë e lëndës.
5. Me 17 janar 2013, ShM-ja ka ofruar vërejtjet rreth pranueshmërisë së lëndës.
6. Me 9 prill 2013, një zyrtar i caktuar nga Misioni ka bërë prezantim me gojë Panelit lidhur me faktet e caktuara që lidhen me zgjidhjen e ankesës.
7. Me 13 korrik 2015, Paneli i ka ofruar avokatit të ankuesve një kopje të një version të redaktuar të këtij prezantimi së bashku me një kërkesë për komentet e tij. Duke vepruar kështu, Paneli ka kërkuar që të sigurohej se ankuesit nuk ishin privuar nga ndonjë informacion që lidhej me ankesën e tyre dhe se ishte ruajtur karakteri kundërshtues i procesit. Përgjigjja e ankuesve më pas iu ishte paraqitur Panelit me datën 27 korrik 2015.
8. Me 30 tetor 2015, EULEX-it i ka paraqitur Panelit një raport të rishikimit të lëndës, i cili në ndërkohë ishte kryer.
9. Me 3 shkurt dhe 20 qershor 2016, ShM-ja ka parashtruar parashtrësia të tjera rreth lëndës. Ai ka tërhequr vëmendjen e Panelit në faktin se parashtrësit e Misionit ishin konsideruar dokumente jopublike të BE-së dhe/ose mund të ndikojnë negativisht në procedimet penale në vazhdim.
10. Këto ishin kushtet që përmbajtja përkatëse e letrave e datave 3 shkurt 2016 dhe 20 qershor 2016 nuk do të ndahej me publikun:
 - i. Para se gjykata e apelit të vendosë për ankimin në lëndën penale;
 - ii. Përderisa dokumenti nuk është i deklasifikuar; dhe
 - iii. Me kusht që identiteti i asnjërit prej personave të përfshirë të mos zbulohet ndonjëherë.
11. Rrjedhimisht, Panelit i janë paraqitur parashtrësit e Misionit, me tekst të plotë, të cilin Paneli nuk ishte në gjendje t'ia përcillte ankuesit për komentet e tij. Prandaj, Paneli duhet të adresojë çështjen procedurale që del në lidhje me mos zbulimin e parashtruesit të ankesës për të gjitha parashtrësit e ShM-së.
12. Paneli së pari vëren në lidhje me këtë se karakteri i vet si një organ llogaridhënës i të drejtave të njeriut të gjetjes së fakteve dhe fushëveprimi i mandatit të tij është i rëndësishëm në këtë kontekst. Sipas Dokumentit Konceptual të Llogaridhënies, dokument i themelimit të Panelit, Paneli është themeluar që "të shqyrtojë ankesat nga secili person, përveç personelit të EULEX-it Kosovë, që pretendon se është viktimë e shkeljes së të drejtave të njeriut nga EULEX-i Kosovë gjatë kryerjes së mandatit ekzekutiv të EULEX-it Kosovë". I njëjti dokument më tutje përcakton se detyra e Panelit është të

“shqyrtojë nëse ka ndodhur ose jo shkelja e të drejtave të njeriut. Ai do të vlerësojë sjelljen e EULEX-it Kosovë në përmbushjen e mandatit të tij ekzekutiv me qëllim të formulimit të rekomandimeve jo detyruese për veprime korrigjuese”.

13. Paneli nuk posedon gamën e plotë të kompetencave që do të gëzonte një organ gjyqësor. Në veçanti, Paneli nuk është i autorizuar të marrë vendime të detyrueshme. Përderisa Koncepti i Llogaridhënies përcakton që Paneli “është i pavarur në ushtrimin e funksioneve të tij që do t’i kryej me paanshmëri dhe integritet”, procedurat pranë tij nuk përcillen nga një varg i tërë i garancive që normalisht do të zbatoheshin në procedurat gjyqësore.
14. Më tutje vihet re se sipas Rregullës 36 të Rregullores së vet të Punës “Paneli do t’i bazojë vendimet dhe gjetjet e veta vetëm në dëshmitë që konsideron se janë përkatëse me ankesën, duke përfshirë dëshmitë që janë mbledhur me nismën e vet”. Paneli normalisht i përmbahet parimit të procedurave kundërshtuese deri në masën e nevojshme për të garantuar drejtësinë e procedurës, edhe pse si rezultat i kësaj nuk është penguar në mbledhjen e informacionit *sipas detyrës zyrtare*.
15. Praktika e zakonshme e Panelit deri më tani ka qenë të bëjë të mundur që palët gjatë procedurave para tij të kenë qasje dhe të komentojnë parashtrirat e palës tjetër. Kjo ka për qëllim të sigurojë drejtësinë dhe siç u përmend më lartë të sigurojë karakterin kundërshtues të procedurave. Ky është gjithashtu një element i rëndësishëm i Panelit që të siguroj se i ka marrë të gjitha informatat përkatëse nga palët në mënyrë që të arrijë në përfundimin e duhur të trajtimit të ankesës.
16. Pavarësisht nga natyra e veçantë e procedurave në Panel, siç është përshkruar më lartë, Paneli ka pasur parasysh standardet për proces të rregullt të garantuara me nenin 6 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (KEDNJ), siç janë të zhvilluara nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GjEDNJ-ja) në lidhje me kufizimet e pranueshme në të drejtën për një procedurë krejtësisht kundërshtuese. Gjykata ka konsideruar se janë të lejuara kufizime të caktuara në kontekstin e atyre situatave ku ekziston bazë e fortë e baraspeshuar e interesit publik, siç është siguria kombëtare, për nevojën që të mbahen sekrete disa metoda policore të hetimeve ose mbrojtjen e të drejtave themelore të personave përveç të akuzuarit, madje edhe në kontekstin e procedurës për përcaktimin e fajit në akuza penale, procedura të cilat normalisht përcillen me garanci të plota të së drejtës për një proces të rregullt gjyqësor në kuptim të nenit 6 të Konventës. Gjykata gjithashtu ka konsideruar se problemi i një gjykimi të drejtë paraqitet nëse vështirësitë që i janë shkaktuar të pandehurit nga ndonjë kufizim i të drejtave të tij nuk janë mjaftueshëm të baraspeshuara nga procedurat prej autoriteteve gjyqësore (shih për shembull, GjEDNJ-në, *Doorson kundër Holandës*, 26 mars 1996, § 70, Raportet 1996-II, *Van Mechelen dhe të tjerët kundër Holandës*, 23 prill 1997, § 58, Raportet 1997-III, *Jasper kundër Mbretërisë së Bashkuar* [GC], numër 27052/95 , §§ 51-53, 16 shkurt 2000, *S.N. kundër Suedisë*, nr. 34209/96, § 47, GjEDNJ-së, 2002-V dhe *Botmeh dhe Alami kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 15187/03, § 37, 7 qershor 2007).

17. Pra, përderisa e drejta për një gjykim të drejtë penal sipas nenit 6 përfshinë në parim të drejtën për zbulimin e plotë të të gjitha provave materiale në posedim të prokurorisë, si për dhe kundër të akuzuarit, gjykata ka vendosur që ndonjëherë mund të jetë e nevojshme që mos t'iu ofrohen dëshmi të caktuara mbrojtjes, për shkak të interesit publik. Në *Jasper* (cituar më lartë, §§ 51-53), gjykata ka konstatuar se kufizimi i të drejtave të mbrojtjes ishte i baraspeshuar mjaftueshëm kur prova që ishte relevante për çështjet në gjykim, por në të cilën prokuroria nuk kishte ndërmend të mbështetej, ishte shqyrtuar *ex parte* nga gjykatësi i procedurës, i cili ka vendosur që nuk duhej të zbulohet, sepse interesi publik në mbajtjen e saj sekret ka tejkaluar dobinë që ka mbrojtja për ta zbuluar atë. Duke gjetur se nuk kishte pasur shkelje të nenit 6, gjykata ka konsideruar të rëndësishme se ishte gjykatësi i procedurës, me njohuri të plotë të çështjeve në gjykim, i cili ka bërë balancimin dhe se ishin ndërmarrë hapa për të siguruar që mbrojtja ishte informuar dhe ishte lejuar të bënte parashtrime dhe të merrte pjesë në procesin e vendimmarrjes për aq sa ishte e mundur pa zbuluar materialin që prokuroria kishte kërkuar ta mbante sekret (ibid., §§ 55-56; shih gjithashtu, për një përmbledhje të parimeve relevante, GjEDNj, *A. kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 3455/05, 19 shkurt 2009, paragrafi 206-211).
18. Së pari Paneli është në dijeni se këto parime janë zhvilluar për qëllime të mbrojtjes efektive të të drejtave të të pandehurve në procedurën penale. Rrjedhimisht nuk mund të supozohet se të gjitha nga to do të ishin të zbatueshme në procedurat pranë Panelit ose në të njëjtën masë, nëse vetëm për shkak se standardet për proces të rregullt të zbatueshme në procedurën penale normalisht janë më të rrepta se në çdo lloj procedure tjetër. Megjithatë këto dallime ndërmjet procedurave penale dhe procedurave pranë Panelit nuk do të thotë se garancitë e tilla themelore të bëhen të parëndësishme për punën e Panelit (shih për shembull, *Hasani kundër EULEX-it*, 2010-05, 14 shtator 2011, paragrafi 61; *Fanaj kundër EULEX-it*, 2010-06, 14 shtator 2011, nenet 61 dhe 61). Për më tepër, Paneli është në dijeni të jurisprudencës që tregon rëndësinë e dëshmimeve që nuk i janë zbuluar palës në procedurë, domethënë se ajo nuk mund të jetë me karakter vendimtar për rezultatin e lëndës (GjEDNj, *Schatschaschwili kundër Gjermanisë* [GC] 9154/10, 15 dhjetor 2015, *mutatis mutandis*).
19. Së dyti, sa i përket garancive të baraspeshuara, Paneli thekson se në rastin në fjalë ka pasur adresim në procedurë me të cilën vetë Panelit iu është dhënë qasje e plotë në informatat e ofruara nga Misioni, duke përfshirë informacionin që konsiderohej tepër i ndjeshëm nga pikëpamja e sigurisë operationale të Programit të Mbrojtjes së Dëshmitarëve për t'iu zbuluar ankuesit dhe publikut. Përderisa Paneli nuk është i lirë t'i shpalosë ato ankuesit ose t'i bëjë ato publike, ky fakt nuk e ka penguar Panelin që mos t'i shqyrtoj në tërësi çështjet e përfshira në këtë rast. Për më tepër, Paneli është i bindur që pamundësia e tij për të zbuluar të gjithë këtë informacion tek ankuesi nuk do ta pengonte mundësinë e tij për të kërkuar një zgjidhje efektive në Panel.
20. Prandaj, duke u varur nga të gjitha masat përkatëse mbrojtëse, Paneli është i autorizuar sipas standardeve të përmendura më lartë që mos t'i zbuloj parashtrimet e plota të Misionit dhe mbi këtë bazë të kryejë funksionet e veta.

21. Duke marrë parasysh faktorët e mësipërme, Paneli është i bindur që procedura e ndjekur ka ruajtur balancën e duhur midis të drejtës procedurale të ankuesve për të argumentuar në mënyrë efektive rastin e tyre dhe nevojën për të ruajtur konfidencialitetin e disa aspekteve të operimit të Misionit në fushën e ndjeshme siç është mbrojtja e dëshmitarëve.

II. PËRMBLEDHJE E FAKTEVE

22. X.F. ishte dëshmitar i prokurorisë në një lëndë të rëndë penale, lidhur me akuzat serioze të ngritura ndaj 10 individëve, të cilat ishin duke u shqyrtuar nga Gjykata Themelore e Prishtinës.
23. X.F. ishte sulmuar dhe lënduar nga persona të paignifikuar në oborrin e shtëpisë së tij në vitin 2009. Gjithsej gjashtë atentate ishin kryer në të nga autorë që mbeten të panjohur. F. (gruaja e X.F.-së, e cila është ankuesja e parë në këtë lëndë) dhe fëmijët e tyre ishin pranuar në Programin për Sigurinë e Dëshmitarëve të EULEX-it në dhjetor 2009. Ankuesit pohojnë se kushtet e tyre gjatë qëndrimit në program ishin shumë të vështira.
24. ShM-ja i ka mohuar këto akuza.
25. Në dhjetor të vitit 2010 familja ishte larguar vullnetarisht nga programi, me sa duket për shkak të presionit të ushtruar ndaj X.F. nga gruaja e tij, e cila ishte e pakënaqur me jetën që familja po bënte derisa ishte e mbrojtur nga zyrtarët e programit të mbrojtjes. Pavarësisht daljes nga programi i mbrojtjes, X.F. ende dëshironte të jepte dëshmi lidhur me këtë rast.
26. Në një datë të pasaktësuar të vitit 2011, një vlerësim i rrezikut ishte kryer nga EULEX-i. Ishte zbuluar se rreziku i sulmit ndaj X.F. dhe familjes së tij mbetej i lartë.
27. Në muajt e parë të vitit 2011 janë kryer një numër arrestimesh në lidhje me lëndën penale të përmendur më lartë.
28. Pas një takimi të mbajtur me datën 18 mars 2011 me menaxhmentin e lartë të Misionit, për X.F. ishte rregulluar që të udhëtonte në Gjermani pas një njoftimi të shpejtë. Prokurori i EULEX-it kishte informuar autoritetet gjermane në një moment të caktuar se F. ishte në rrugën e sipër për në Gjermani. Një sasi parash ishte caktuar nga fondet e Misionit për të financuar qëndrimin e F.-së në Gjermani ku ai kishte lidhje familjare.
29. Në një kohë të papërcaktuar policia gjermane (BKA) ishte informuar për qëndrimin e X.F.-së në Gjermani.
30. Në korrik 2011, X.F. ishte kthyer në Kosovë ku kishte dhënë deklaratë në seancën paraprake në këtë rast. Më pas ai ishte ripranuar në programin e mbrojtjes së dëshmitarëve të EULEX-it në mënyrë që të merrte ndihmë financiare dhe ndihma të tjera nga ky program.
31. Menjëherë pas kësaj, ai ishte kthyer në Gjermani pasi edhe një herë e kishte lënë programin e mbrojtjes (shoqëruar nga zyrtarë të DSD-së të EULEX-it).

32. Me 28 shtator 2011, X.F. kishte vdekur në Gjermani.
33. Një hetim i kryer nga policia gjermane kishte përcaktuar se ai kishte kryer vetëvrasje.
34. Procedurat penale ndaj të pandehurve më pas u kryen në gjykatat e Kosovës. Në vitin 2013 Gjykata Themelore e Prishtinës kishte dhënë gjykimin e saj. Të gjithë të pandehurit ishin shpallur të pafajshëm.
35. Prokurori i EULEX-it kishte bërë ankesë. Në vitin 2016, Gjykata e Apelit ka hedhur poshtë këtë ankesë.
36. Më pas, Prokurori i EULEX-it i Zyrës së Prokurorit të Shtetit ka paraqitur një kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ndaj këtij aktgjykimi. Në vitin 2017, Gjykata Supreme e Kosovës ka hedhur poshtë ankimimin e Prokurorit për atë gjykim.

III. ANKESAT

37. Ankuesit pohojnë se X.F. dhe familja e tij kanë përjetuar kushte shumë të këqija të jetës dhe izolim përderisa ai ka qenë në Programin e Mbrojtjes së Dëshmitarëve. Ata pohojnë se pasi familja ishte larguar nga programi, F. ishte mbajtur në izolim, i ndarë nga familja e tij dhe se nuk kishte kontakt me ta.
38. Ankuesit më tutje pohojnë se presioni psikologjik që i ishte nënshtruar X.F., si dhe trajtimi i tij i përgjithshëm nga EULEX-i dhe izolimi i tij nga familja gjatë kohës sa ishte në Programin për Mbrojtjen e Dëshmitarëve dhe më vonë në Gjermani, e kishte çuar në kryerjen e vetëvrasjes. Pretendohet se EULEX-i ishte në dijeni për gjendjen e tij mendore, por nuk arriti të ndërmerre hapa të duhura për të parandaluar vdekjen e tij. Ata kërkojnë që personat përgjegjës për shkeljet e pretenduara të të drejtave të familjes F. dhe vdekjen e X.F. të sillen para drejtësisë.

IV. LIGJI

39. Ankuesit pohojnë se X.F. dhe familja e tij kanë përjetuar kushte shumë të këqija të jetës dhe izolim përderisa kanë qenë në Programin e Mbrojtjes së Dëshmitarëve.
40. Si çështje e së drejtës materiale, Paneli është i autorizuar që të përdor instrumentet e të drejtave të njeriut siç pasqyrohen në konceptin llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 mbi themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut. Me rëndësi të veçantë për punën e Panelit janë Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (Konventa) dhe Konventa Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike, të cilat përcaktojnë standardet minimale për mbrojtjen e të drejtave të njeriut që duhet të garantohen nga autoritetet publike në të gjitha sistemet ligjore demokratike.

41. Para shqyrtimit të bazueshmërisë së ankesës, Paneli duhet të vendos nëse do ta pranoj ankesën, duke marrë parasysh kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me rregullën 29 të rregullores së vet të punës.
42. Sipas rregullit 25, paragrafi 1 i rregullores së punës, Paneli mund t'i shqyrtojë vetëm ankesat që kanë të bëjnë me shkeljet e të drejtave të njeriut të kryera nga EULEX-i Kosovë gjatë kryerjes së mandatit të tij ekzekutiv. Sipas rregullës 25, paragrafi 1 i rregullores së punës, ankesat duhet të parashtrihen brenda afatit gjashtë mujor nga data e shkeljes së supozuar.
43. Paneli ka shqyrtuar ankesat e parashtruara nga ankuesit sipas nenit 2 dhe 3 të Konventës, të cilat për aq sa janë relevante përcaktojnë që:
- “ Neni 2
1. E drejta e çdo njeriu për jetën mbrohet me ligj. Askujt nuk mund t'i privohet qëllimisht jeta, me përjashtim të rastit, kur zbatohet një vendim me vdekje i dhënë nga një gjykatë, kur krimi ndëshkohet me këtë dënim nga ligji.
- [...]
- Neni 3
- Askush nuk mund t'i nënshtrohet torturës ose dënimeve ose trajtimeve çnjerëzore ose poshtëruese.”
44. Paneli thekson se në rastin në fjalë familja e ka lënë programin e mbrojtjes së dëshmitarit me datën 29 dhjetor 2010. Ankesa ishte parashtrua në Panel me 14 nëntor 2011, pra jashtë afatit gjashtëmujor të paraparë me rregullën 25, par. 3 të rregullores së punës.
45. Nga kjo del se kjo pjesë e ankesës duhet të shpallet e papranueshme.
46. Faktet lidhur me pjesëmarrjen e familjes F. në Programin e Dëshmitarëve të Mbrojtur mund të merren në konsideratë nga Paneli vetëm si informatë rreth rastit. Paneli rezervon të drejtën për t'i marrë ato në konsideratë, në veçanti në kontekstin e aspektit tjetër të ankesave, pra sugjerimin se pjesëmarrja e tyre në këtë program dhe rrethanat në të cilat ata ishin pranuar dhe trajtuar ishin faktor kontribues i vdekjes së X.F.-së.
47. Më tej ankuesit ankohen se Misioni ka dështuar të ndërmerr masat e duhura për të mbrojtur jetën e X.F.-së dhe nuk ka arritur të hetojë rrethanat që kanë çuar në vdekjen e tij. ShM-ja nuk është pajtuar me këtë sugjerim.
48. Paneli së pari vëren se kjo pjesë e ankesës ka të bëjë kryesisht me veprimet e autoriteteve prokuroriale dhe autoriteteve policore të EULEX-it. Paneli tashmë ka gjetur në shumë raste se veprimet e prokurorëve dhe policisë së EULEX-it janë pjesë e mandatit ekzekutiv të EULEX-it Kosovë dhe prandaj bien në kuadër të juridiksionit të Panelit (shih për shembull, *K. deri T. kundër EULEX-it*, lëndët nr. 2013-05 në 2013-14, 21 prill 2015, *Krlić kundër EULEX-it*, 2012-21, 26 gusht 2014, *Y kundër EULEX-it*, nr. 2011-28, 15 nëntor 2012, paragrafi 35). Prandaj Paneli konsideron se ka juridiksion *ratione personae* për të shqyrtuar këtë ankesë.
49. Duke marrë parasysh faktorët e mësipërm, Paneli konstaton se ka juridiksion të shqyrtojë pjesën e mbetur të ankesës.

50. Paneli konsideron që, në bazë të parashtresave të palëve, ankesa ngrit çështje serioze të fakteve dhe ligjit sipas nenit 2 dhe 3 të Konventës, përcaktimi i të cilave kërkon shqyrtimin e bazueshmërisë së lëndës. Prandaj Paneli konkludon se ankesa nuk është qartazi e pabazuar. Nuk është vërtetuar ndonjë arsye tjetër që ajo të shpallet e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE, PANELI, NJEZËRI,

E SHPALL të pranueshme ankesën e bërë sipas nenit 2 dhe nenit 3 të Konventës, pa paragjykuar meritat;

E SHPALL PJESËN TJETËR TË ANKESËS TË PAPRANUESHME,

E RUAN përcaktimin e procedurës së ardhshme në Panel.

Për Panelin,

John J. RYAN
Zyrtar i lartë ligjor



Magda MIERZEWSKA
Kryesuese